



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2021

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 25.11.2021)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr. 182, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidaten znj. {...}”, relator A.Toro.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Maksim Qoku.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:34 dhe mbaroi në orën 12:04.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
- 2. Medi Bici*** (anëtar)
- 3. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 4. Dritan Hallunaj*** (anëtar)
- 5. Ilir Toska*** (anëtar)
- 6. Alban Toro*** (anëtar)
- 7. Marçela Shehu*** (anëtare)
- 8. Erjon Muharremaj*** (anëtar)

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Brunilda Kadi*, anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Brikena Ukperaj*.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. Maela Alicanaj, Drejtore pranë Departamentit të shërbimeve juridike dhe marrëdhënieve me jashtë.

2. Staf administrativ i KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr. 182, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidaten *znj. {...}*”, relator A.Toro.

Maksim Qoku: Përshëndetje të nderuar anëtarë!

Sot do zhvillojmë një mbledhje, të datës 25 nëntor 2021 me dy çështje në rendin e ditës.

Mbledhja do të drejtohet nga unë Zëvendëskryetari, për shkak të impenjimeve që ka Kryetarja në aktivitetet e Këshillit. Në bazë të nenit 68, paragrafi i parë bëhet kuorumi për të zhvilluar mbledhjen në prezencën e shtatë anëtarëve. Për shkaqe objektive, anëtarët e tjerë janë të angazhuar në aktivitete që kanë të bëjnë me punën e tyre në Këshill.

Çështja e parë e rendit të ditës do të jetë shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr. 182, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidaten *znj. {...}*”, me relator z. Toro.

Çështja e dytë, shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, relator z.Toska.

Nëse nuk ka gjë nga anëtarët për rendin e ditës, vazhdojmë me shqyrtimin e çështjes së parë.

Zoti Toro, fjala për ju!

Alban Toro: Faleminderit!

Më herët me vendimet nr. 182, nr. 183 dhe nr. 185, datë 28.05.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ky i fundit ka vendosur hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë për tre pozicione, dy në fushën e së drejtës civile dhe një në fushën e së drejtës penale.

Një nga kandidatët ka qenë edhe zonja {...} e cila është gjyqtare e emëruar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, aktualisht e komanduar inspektore pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Me Vendimin nr. 238, datë 07.07.2020, kanë filluar procedurat e verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe ndërkohë, me vendimin nr.309, datë 10.09.2020, Këshilli ka vendosur:

“1. Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për dy pozicionet e lira, në fushën e të drejtës civile dhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet nr. 182 dhe nr. 183 dhe nr. 185, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të kriterëve të parashikuara nga neni 47, paragrafi 4, 48 paragrafi 8, dhe 8/3 i Ligjit për Statusin, përkatësisht të kriterëve që kanë të bëjnë me “përvojën profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

Më tej ky Këshill ka vijuar procedurat e verifikimit të kandidatës për kriteret e tjera ligjore.

Me Vendimin nr. 205, datë 20.05.2021, Këshilli ka vendosur:

“1. Kualifikimin e kandidatës znj. {...} dhe vijimin e procedurave të emërimit në Gjykatën e Apelit Tiranë, (në fushën e të drejtës civile), për dy pozicionet e lira, të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 181 dhe nr. 182 datë 28.05.2020 dhe (në fushën e

të drejtës penale), për pozicionin e lirë, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 185 datë 28.05.2020.”

Bazuar në Vendimin nr.70, datë 07.02.2020, Këshilli ka vendosur:

“1.Fillimin e procedurave të përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pesë pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimet nr. 179, nr. 180, nr. 181, nr. 182 dhe nr. 183, datë 28.05.2020...”, duke përcaktuar edhe relatorin përkatës.

Ndërsa për kandidaten vijonin procedurat e përzgjedhjes në kuadër të kandidimeve të saj, kandidatja ka parashtruar një kërkesë nëpërmjet të cilës hiqte dorë nga kandidimi për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 182, datë 28.05.2020, duke vijuar kështu tashmë kandidimin për dy pozicionet e tjera të lira, ato në fushën e së drejtës civile dhe penale, të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 183 dhe nr. 185, datë 28.05.2020.

Në këto rrethana, duke qenë se është një akt i bazuar në vullnetin e kandidates është përgatitur projektvlerësimi përkatës, në dispozitivin e të cilit ju sugjerohet të miratoni:

1.Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 182, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi për këtë pozicion.

2.Një kopje e arsytuar e vendimit i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjektit.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

Maksim Qoku: Faleminderit, zoti Toro!

Nëse anëtarët nuk kanë gjë për të shtuar, mund të kalojmë në votim.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Maksim Qoku: Dakord.

Atëherë, Këshilli miratoi vendimin e sa më sipër relatuar nga zoti Toro.

* * *

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2021

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 25.11.2021)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ilir Toska).¹

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Maksim Qoku.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:34 dhe mbaroi në orën 12:04.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------|---------------------------------|
| 1. Maksim Qoku | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| 2. Medi Bici | <i>(anëtar)</i> |
| 3. Fatmira Luli | <i>(anëtare)</i> |
| 4. Dritan Hallunaj | <i>(anëtar)</i> |
| 5. Ilir Toska | <i>(anëtar)</i> |
| 6. Alban Toro | <i>(anëtar)</i> |
| 7. Marçela Shehu | <i>(anëtare)</i> |
| 8. Erjon Muharremaj | <i>(anëtar)</i> |

¹ Procesverbali i kësaj çështjeje të rendit të ditës është përmbledhje.

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Brunilda Kadi*, anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Brikena Ukperaj*.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Maela Alicanaj, Drejtore pranë Departamentit të shërbimeve juridike dhe marrëdhënieve me jashtë.*
- 2. Valbona Bako, Përgjegjëse pranë Sektorit të përgatitjes së dokumentacionit dhe përfaqësimit në gjykatë.*
- 3. Staf administrativ i KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ilir Toska).

Çështja e fundit e rendit të ditës së datës 25.11.2021 ka të bëjë me caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme.

Fjala i jepet relatorit të çështjes, z. Toska.

Relator i kësaj çështjeje është zoti Ilir Toska.

Sot janë për trajtim kërkesat nga 12 gjykatave për caktim gjyqtarësh në çështje gjyqësore të veçanta.

Fillimisht zoti Toska relaton shkurtimisht relacionin sa i përket radhës së shortit duke i propozuar Këshillit që procedurat e shortit të ndiqen sipas kësaj radhe:

Gjykatat e shkallës së parë, sipas kësaj radhe: Gjykatat e shkallës së parë sipas juridiksioneve të gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm: Gjykatat e shkallës së

parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Durrës: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë.

Gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Tiranë: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë.

Gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Vlorë: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

Gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit administrativ: Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë.

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

Gjykatat e apeleve, sipas kësaj radhe:

Gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm: Gjykata e Apelit Durrës, Gjykata e Apelit Gjirokastrë, Gjykata e Apelit Korçë, Gjykata e Apelit Shkodër, Gjykata e Apelit Vlorë.

Pasi anëtarët janë dakord me radhën e shortit, vijohet me relatimin e relacionit të parë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore, në lëndë penale.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit (sa kohë të 14 gjyqtarët e caktuar në skemën e delegimit janë caktuar për kohë afatgjatë) dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, përfshirë edhe gjyqtarët e transferuar të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1.

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjeve, si përjashtim nga rregulli, në kushtet e numrit të kufizuar të gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, të mos përjashtohet nga shorti kryetarja në detyrë e saj, konkretisht: Znj. Diamela Goxha.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarja Diamela Goxha.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të dytë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë** ka paraqitur nevojë për 2 çështje gjyqësore, në lëndë civile dhe penale.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 2.

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjeve të përjashtohet nga shorti Kryetari në detyrë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, konkretisht: Z. Markelian Koça.

Në shortimin e çështjeve të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, të cilët janë caktuar më herët, gjatë vitit 2021, në një ose më shumë çështje në gjykata të tjera të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme, konkretisht: Znj. Flora Hasimi, Z. Petraq Çuri, Z. Rexhep Bekteshi, Znj. Shpetime Pitaku, Z. Vladimir Skenderi, Z. Paulin Çera, Znj. Besjana Garxenaj.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtar Shpëtim Reka.

Për çështjen nr. 1, civile, gjyqtarja Nurjeta Tafa.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të tretë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore, në lëndë penale.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçanta, të jetë 1.

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjes të përjashtohet nga shorti gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, për të cilin është zhvilluar seanca dëgjimore për çështjen e rivlerësimit

përpara Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, konkretisht: Z. Rexhep Karaj.

Në shortimin e çështjeve, si përjashtim nga rregulli, në kushtet e ngarkesës relativisht jo të lartë dhe numrit të kufizuar të gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, të mos përjashtohet nga shorti Kryetari në detyrë i kësaj gjykate, konkretisht: Z. Artan Çupi.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtar Artan Çupi.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të katërt “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore, në lëndë penale.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1.

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjes të përjashtohet nga shorti gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, për të cilin është zhvilluar seanca dëgjimore për çështjen e rivlerësimit përpara Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, konkretisht: Z. Rexhep Karaj.

Në shortimin e çështjes të përjashtohet nga shorti gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat që do të caktohet për të gjykuar çështjen gjyqësore të veçantë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër (zoti Artan Çupi).

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarja Suela Lika.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të pestë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore, në lëndë penale.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1.

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjeve të përjashtohet nga shorti gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, që është caktuar më herët për gjykimin e saj, konkretisht: Znj. Matilda Llangozi.

Në shortimin e çështjeve të përjashtohet nga shorti gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, e cila është përjashtuar nga lista e gjyqtarëve që mund të caktohen për

gjykimin e çështjeve të veçanta, konkretisht: Znj. Klejda Çapja.

Gjyqtarja nuk mund të marrë pjesë sa kohë ajo është caktuar më herët për gjykimin e kësaj çështjeje, por për shkak të mosparaqitjes në detyrë për të një periudhë të gjatë ëpr arsye shëndetësore si dhe për shkak të marrjes së lejes së barrë-lindjes, ka lindur edhe nevoja në rastin konkret për kërkesën e paraqitur.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarja Lutfije Celami.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të gjashtë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore.

Për nevojat si më lart të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, përfshirë edhe gjyqtarët e transferuar përkohësisht pranë kësaj gjykate.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 2.

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e kësaj çështjeje të përjashtohet nga shorti Kryetari në detyrë i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, konkretisht: Z. Bevis Shehaj.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, gjyqtarët Hazbi Balliu dhe Ema Shaholli.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të shtatë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore, në lëndë penale.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykatat nga duhet të përzgjidhet gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë, të jenë gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm.

Gjyqtari për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë, të përzgjidhet, me short, ndërmjet atyre të cilët kanë të paktën shtatë vjet përvojë në ushtrimin e profesionit, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar për çështjet penale, si dhe kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1 (një).

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjes të përjashtohet nga shorti gjyqtarja e gjykatës së shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm që plotëson kriteret si më lart, e cila nuk ushtron funksionin përkohësisht për arsye shëndetësore, konkretisht: Znj. Ornela Naqellari.

Në shortimin e çështjes të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm që plotësojnë kriteret si më lart, të cilët janë caktuar më herët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, konkretisht: Z. Petrit Çomo, Znj. Alma Ahmeti, Z. Genti Dokollari, Z. Sokol Pina, Z. Ilir Përdeda, Z. Dritan Hasani, Znj. Irida Kacerja, Z. Gerd Hoxha, Znj. Alma Kolgjoka, Znj. Manjola Xhaxho, Znj. Esmeralda Xhili (Çeka), Znj. Emona Muçi, Z. Rexhep Bektashi, Znj. Migena Laska, Znj. Diamela Goxha.

Ndër gjyqtarët e gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm që kanë të paktën shtatë vjet përvojë në ushtrimin e profesionit dhe kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, janë edhe gjyqtarët Elona Mihali, Arta Duka, Marsela Dervishi dhe Irena Plaku, por nga verifikimet e bëra deri më sot nuk rezulton që të kenë të paktën pesë vjet si gjyqtar për çështjet penale, verifikuar kjo në kuadër të kandidimeve të tyre për ngritjen në detyrë në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm.

Po ashtu, ndër gjyqtarët e gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm që kanë të paktën shtatë vjet përvojë në ushtrimin e profesionit, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar për çështjet penale, si dhe kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, janë edhe gjyqtarët {...}, {...} dhe {...}, të cilët janë aktualisht gjyqtarë të skemës së delegimit dhe që si të tillë, ndërsa plotësojnë kushtet dhe kriteret për t’u caktuar në GJPSHPKKO, në zbatim të nenit 45 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, janë caktuar për periudha afatgjata për gjykimin e çështjeve të veçanta në këtë të fundit.

Gjithashtu, ndër gjyqtarët e gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm që kanë të paktën shtatë vjet përvojë në ushtrimin e profesionit, nga të cilat

të paktën pesë vjet si gjyqtar për çështjet penale, si dhe kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, janë edhe gjyqtarët {...}, {...} dhe {...}, të cilët janë aktualisht gjyqtarë të skemës së delegimit dhe që si të tillë, ndërsa plotësojnë kushtet dhe kriteret për t’u caktuar në GJPAKKO, në zbatim të nenit 45 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, po caktohen për gjykimin e çështjeve të veçanta në këtë të fundit.

Së fundi, ndër gjyqtarët e gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm që kanë të paktën shtatë vjet përvojë në ushtrimin e profesionit, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar për çështjet penale, si dhe kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, është edhe gjyqtarja Lutfije Celami, por nga verifikimet e bëra rezulton se ajo është në kushtet e papajtueshmëri ambientale për t’u caktuar për të gjykuar në GJPSHPKKO, referuar nenit 8 të për të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarja Adelajda Gjuzi.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të tetë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Durrës”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Durrës** ka paraqitur nevojë për 3 çështje gjyqësore, në lëndë penale.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Apelit Durrës në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të

veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 3 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Apelit Shkodër, përfshirë dhe gjyqtarin e skemës së delegimit të caktuar pranë saj.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 3 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 4.

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjes të përjashtohet nga shorti Kryetari i Gjykatës së Apelit Shkodër, konkretisht: Z. Fuat Vjerdha.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtar Tonin Stërkaj.

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarja Vojsava Osmanaj.

Për çështjen nr. 3, penale, gjyqtarët Astrit Kalaja dhe Valbona Vata.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të nëntë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Gjirokastrë** ka paraqitur nevojë për 3 çështje gjyqësore, në lëndë penale.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 3 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Apelit Korçë, përfshirë gjyqtarët e skemës së delegimit të caktuar pranë Gjykatës së Apelit Korçë.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 3 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 3.

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjeve, si përjashtim nga rregulli, në kushtet e ngarkesës relativisht jo të lartë dhe numrit të kufizuar të gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Korçë, të mos përjashtohet nga shorti Zëvendëskryetarja e kësaj gjykate, konkretisht: Znj. Arta Duka.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtar Dritan Hasani.

Për çështjen nr. 3, penale, gjyqtarja Sonjela Voskopi.

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarja Arta Duka.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të dhjetë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Korçë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Korçë** ka paraqitur nevojë për 3 çështje gjyqësore, në lëndë penale.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Apelit Korçë në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 3 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Apelit Tiranë. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 3 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 3.

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjes të përjashtohet nga shorti kryetari në detyrë i Gjykatës së Apelit Tiranë, konkretisht: Z. Ridvan Hado.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarja Edlira Petri.

Për çështjen nr. 3, penale, gjyqtarja Valdete Hoxha.

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtarja Elona Toro.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të njëmbëdhjetë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Shkodër”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Shkodër** ka paraqitur nevojë për 2 çështje gjyqësore, në lëndë penale.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Apelit Shkodër, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Apelit Durrës, përfshirë dhe gjyqtarët e skemës së delegimit të caktuar pranë kësaj gjykate.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 3.

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjeve të përjashtohet nga shorti Kryetari në detyrë i Gjykatës së Apelit Durrës, konkretisht: Z. Valbon Çekrezi.

Në shortimin e çështjes nr. 2 të përjashtohet nga shorti gjyqtari i skemës së delegimit i caktuar pranë Gjykatës së Apelit Durrës, i cili është caktuar më herët për gjykimin e saj, konkretisht: Z. Florjan Kalaja.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtarja Irida Kacerja.

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarët Florjan Kalaja dhe Anita Mici.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të fundit “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Vlorë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Vlorë** ka paraqitur nevojë për 2 çështje gjyqësore, në lëndë civile dhe penale.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Apelit Vlorë, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Apelit Gjirokastrë, përfshirë dhe gjyqtarin e skemës së delegimit të caktuar pranë saj.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 4.

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjeve të përjashtohet nga shorti Kryetari në detyrë i Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, konkretisht: z. Dritan Banushi.

Në shortimin e çështjes nr. 1 të përjashtohet nga shorti gjyqtari i skemës së delegimit i caktuar pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, që ka pengesë ligjore për gjykimin e saj, konkretisht: z. Sokol Pina.

Në shortimin e çështjes nr. 2 të përjashtohen gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, që kanë pengesë ligjore ose janë caktuar më parë për gjykimin e saj, konkretisht: znj. Miranda Andoni, z. Sokol Pina.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtar Enton Dhimitri.

Për çështjen nr. 1, civile, gjyqtarët Miranda Andoni (relatore), Enton Dhimitri dhe Irena Brahimi (anëtarë).

Me kaq mbyllet procedura e shortit dhe në tërësi e gjithë mbledhja plenare.

* * *

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor